



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/112

Datë: 09.01.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafit 3 të nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-036 për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 janar 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi i Statistikave Zyrtare për vitin 2013-2017.
2. Obligohet Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe institucionet tjera prodhuese të statistikave për zbatimin e programit nga pika 1. e këtij vendimi
3. Obligohet Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe institucionet tjera që prodhojnë statistika zyrtare, që pjesën e implikimeve financiare të këtij Programi ta harmonizojnë për çdo vit me Ligjin për Buxhetin sipas viteve pasuese, nga viti 2014 deri në vitin 2017.
4. Programi nga pika 1. e këtij vendimi të publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë